

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GLOBAL IVF CLINIC" SH.P.K

Sot, më datë 15/01/2025 (dy mijë e njezet e pese), une znj. Gjina Zeqiri, shtetase e Kosoves e datëlindjes 28/07/1962, e lindur ne Tupalle - Serbi dhe banuese e Kosoves ne Prishtine, rruga Ndue Perlleshi 30-32, Mati I, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me numer personal 1004211711, vendosa te themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqerise eshte " **GLOBAL IVF CLINIC**" **Sh.P.K.** Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**GLOBAL IVF CLINIC**" **SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe ne Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Eshte fitim prures, ndersa fusha e veprimtarise jane kryesisht sherbimet mjekesore, si sherbimet gjinekologjike, aplikimi i procedurave te fertilizimit te asistuar mjekesor gjegjesisht in vitros etj.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin "**GLOBAL IVF CLINIC**" **SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë është Mjekesi, Gjinekologji, infertilitet dhe frytnim i asistuar mjekesor apo in vitro, duke përfshirë çdo veprimtari tjetër të kësaj fushe të lejuar nga legjislacioni shqiptar.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në rrethin e Tiranës, bashkia Tirane, Laprake, rruga Lord Bajron, pallati i bardhe e blu, brenda ambjenteve të klinikës Royal Diagnostic Center. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 1.000.000 (një milion) leke, 100 % Ortake - themelues është znj Gjina Zeqiri e Shoqërisë Tregtare "GLOBAL IVF CLINIC" SH.P.K., të cilet zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë: znj Gjina Zeqiri, shtetase e Kosovës e datëlindjes 28/07/1962, e lindur në Tupallë - Serbi dhe banuese e Kosovës në Prishtinë, rruga Ndue Perlleshi 30-32 Mati I, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal 1004211711, zotëruese e kuotave të përbërë nga 1.000.000 (një milion) lekë, duke përfaqësuar 100 %, të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar do të shlyet plotësisht në para nga Ortaket me themelimin e Shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare. Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901 të datës 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga 1 Administrator i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë znj. Gjina Zeqiri, shtetase e Kosovës e datëlindjes 28/07/1962, e lindur në Tupallë - Serbi dhe banuese e Kosovës në Prishtinë, rruga Ndue



Perlleshi 30-32, Mati I, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me numer personal 1004211711, shtetase e Kosoves.

NENI 9

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje.

Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKE THEMELUES

GJINA ZEQRIRI

GJINA ZEQRIRI

Gjina Zeqiri